

OBSERVATORI I EKONOMIVE TË PALIGJSHME NË EVROPËN JUGLINDORE

NUMRI

13 SHTATOR-TETOR 2022

Përmbledhje e pikave kryesore

3. Arrestimet ndaj oficerëve të policisë në Kosovë sinjalizojnë praninë e kulturës së marrjes së ryshfetit në radhët e policisë dhe një sistem të fuqishëm hetimi të brendshëm në Inspektoratin Policor.

Në gjysmën e parë të vitit 2022, 5% e policisë kufitare të Kosovës u arrestua si pasojë e operacioneve të luftës kundër korrupsionit. Ka edhe një prirje në rritje të ankesave kundër Policisë së Kosovës gjatë dy viteve të fundit, ku përfshihen rastet e marrjes së ryshfetit dhe keqpërdorimi i detyrës zyrtare ose autoritetit. Edhe pse pjesa më e madhe e ryshfeteve ishin të vogla për nga shuma, në të shkuarën ka pasur raste më serioze të bashkëpunimit me grupe kriminale. Pavarësisht sistemit hetimor të brendshëm të rreptë të Inspektoratit Policor, më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet parandalimit, sidomos nëpërmjet forcimit të integritetit në radhët e brezit të ri të personelit të zbatimit të ligjit.

4. Rritet popullariteti i rrugëve detare për trafikimin përmes Ballkanit.

Pandemia "kovid-19" dhe lufta në Ukrainë i kanë çrregulluar rrugët e trafikimit që kalojnë përmes

Ballkanit. Në të njëjtën kohë, përmirësimet e infrastrukturës së terminaleve për anije kontejnerësh dhe qasja në terminale (p.sh. si hallka të lidhjes me autostradë dhe hekurudhë) i kanë bërë portet tregtare të Evropës juglindore më tërheqëse edhe për tregtinë e ligjshme, por edhe për të paligjshmen. Siç shtjellohet në një raport të ri të GI-TOC-së, këto ndryshime duket se kanë shtuar trafikimin në rrugë detare drejt deteve Adriatik, Egje, të Zi dhe lumit Danub.

6. Rrogat e ulëta të oficerëve të policisë në Ballkanin Perëndimor rrezikojnë të çojnë në rritjen e korrupsionit në radhët e tyre.

Publiku pret shumë nga oficerët e policisë: të reagojnë shpejt në raste urgjence; të vënë në rrezik jetën për të mbrojtur komunitetin dhe zbatuar ligjin; dhe ta realizojë me profesionalizëm dhe integritet punën e tyre të vështirë dhe të rrezikshme. Megjithatë, edhe pse pritshmëritë janë të mëdha, rrogat e oficerëve të policisë në Ballkanin Perëndimor janë relativisht të ulëta. Ky hendek rrit rreziqe të caktuara, duke përfshirë rrezikun e korrupsionit. Në këtë numër, do ta



shqyrtojmë këtë problem, ndikimin që ai ka dhe se çfarë mund të bëhet për t'i dhënë zgjidhje.

7. Huliganizmi në futboll në Ballkanin Perëndimor nxjerr në pah lidhjet midis huliganizmit, politikës, dhunës dhe krimit, edhe pse këto ndryshojnë nga njëri vendi i rajonit në tjetrin.

Disa ekipe futbollit në Ballkanin Perëndimor— si në nivel klubi, ashtu edhe në nivel kombëtar—njihen për dhunë. Por sa serioz është ky problem dhe cilat janë lidhjet midis huliganizmit në futboll, politikës dhe krimit të organizuar? Përgjigjet shqyrtohen në një raport të fundit të GI-TOC-së që quhet “Lojëra të rrezikshme”, ku analizohen 122 grupe tifozësh të ekipeve të futbollit në gjashtë vende të rajonit. Në këtë artikull pasqyrohen gjetjet e këtij hulumtimi.

Arrestimet ndaj oficerëve të policisë në Kosovë sinjalizojnë praninë e kulturës së marrjes së ryshfetit në radhët e policisë dhe një sistem të fuqishëm hetimi të brendshëm në Inspektoratin Policor.

Në gjysmën e dytë të vitit 2022, 5% e policisë kufitare të Kosovës u arrestua si shkak i një numri operacionesh kundër korrupsionit. Nga raportet e fundit duket se ka një prirje në rritje të ankesave kundër policisë. Çfarë nxjerrin në dritë këto raste për Policinë e Kosovës dhe për ata që e mbikëqyrin?

Në Policinë e Kosovës, e themeluar në vitin 1999, aktualisht janë të punësuar 9 070 veta, nga të cilët 8 104 janë me uniformë, ndërsa 968 janë civilë.¹ Policia gëzon reputacion të mirë në sytë e popullit të Kosovës: midis periudhës 2015-2021, policia është perceptuar si organizata më pak e korruptuar në vend,² dhe institucioni i dytë më i besuar pas Forcës së Sigurisë të Kosovës.³

Policia mbikëqyret nga Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), i themeluar në vitin 2006, si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Aktualisht, në IPK janë punësuar 93 vetë, nga të cilët gjysma punojnë në Departamentin e Hetimit.⁴ IPK kontribuon në sigurimin e llogaridhënies dhe transparencës në polici kryesisht nëpërmjet parandalimit, zbulimit, dokumentimit dhe hetimit të veprave penale dhe inspektimit të strukturave dhe funksioneve të policisë.

Në maj të vitit 2021, IPK-ja, në bashkërendim me Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), nisi një hetim ndaj oficerëve të policisë që punojnë në dy pikat e kalimit kufitar midis Kosovës dhe Shqipërisë, d.m.th. në Qafë Prush dhe në Qafë Morinë.⁵ Së bashku me pikën e kalimit kufitar Vermicë-Morinë, këto pika të kalimit kufitar janë identifikuar më përpara nga GI-TOC-ja si zona problematike të trafikimit të drogës.⁶ Hetimi u nis mbështetur në informacione nga një burim i besueshëm, ku thuhej se drogat (kryesisht kanabis) po trafikoheshin përmes dy pikave të kalimit kufitar, me mbështetjen e oficerëve të policisë kufitare, të cilët siguronin transportin deri në Mitrovicën e Veriut.⁷ Në videot e incizuar me kamera të fshehta paraqiten zyrtarë të policisë kufitare që

janë përfshirë në veprimtari kriminale, duke përfshirë më shumë se 400 raste marrjeje ryshfeti dhe keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar.⁸ Hetimi çoi në arrestimin e 48 oficerëve të policisë kufitare dhe të dy oficerëve të doganës në 14 mars 2022,⁹ duke përfshirë gjithë ekipin prej 19 zyrtarësh që punonin në pikën e kalimit kufitar në Qafë Prush.

Gjatë mbikëqyrjes, IPK-ja konstatoi parregullsi edhe në pikën tjetër të përbashkët të kalimit kufitar me Shqipërinë në Vermicë-Morinë. Duke qenë se pika e kalimit kufitar ndodhet në territorin e Shqipërisë, IPK-ja punoi me PSRK-së, me Strukturën e Posaçme Anti-Korrupsion të Shqipërisë dhe me Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore për të realizuar një hetim të përbashkët.¹⁰ Ky hetim u realizua në përputhje me një memorandum mirëkuptimi për bashkëpunim në fushën e kontrollit të brendshëm dhe mbikëqyrjes policore¹¹ dhe një protokoll për inspektime të përbashkëta, të nënshkruar nga autoritetet kosovare dhe shqiptare.¹²

Nisur nga mënyra se si u realizua operacioni, na u bë e qartë se kishte një shkallë të lartë profesionalizmi. U formua një grup pune me 12 hetues, të cilët punuan në një sallë të veçuar brenda Inspektoratit dhe i raportonin vetëm drejtuesit të grupit të punës dhe drejtorit të IPK-së. Fakti që integriteti i procesit u ruajt pavarësisht përfshirjes së gjashtë institucioneve të dy shteteve të lë të kuptosh që ka pasur bashkëpunim të ngushtë dhe disiplinë të kënaqshme ndërmjet atyre që morën pjesë në këtë hetim.¹³

Operacioni i përbashkët përfundoi në datën 8 prill 2022 me arrestimin e 58 oficerëve të policisë kufitare. 26 oficerë të policisë kufitare të Kosovës, duke përfshirë dy rreshterë, u arrestuan në Kosovë,¹⁴ kurse autoritetet shqiptare arrestuan 32 oficerë të policisë kufitare në bazë të dyshimeve për marrje ryshfeti në më shumë se 312 raste.¹⁵ Incizimet me kamerat e mbikëqyrjes tregojnë oficerë të policisë kufitare që marrin 10-20 euro

ryshfet nga qytetarët që nuk kishin dokumentet e duhura për të udhëtuar dhe/ose për mallrat në lëvizje.¹⁶

Sipas IPK-së, në shumicën e rasteve, zyrtarët e arrestuar vepronin vetëm. Në pak raste, ata bashkëpunonin me njëri-tjetrin dhe vepronin bashkë, por nuk ka shenja që tregojnë se janë përfshirë me grupet e krimit të organizuar.¹⁷ Ia vlen të theksohet se mosha mesatare e zyrtarëve të arrestuar ishte 50 vjeç, çka nënkupton se ndoshta ka ardhur koha për të ndërruar brezin e policëve me policë të rinj.¹⁸

Hetimi ndaj oficerëve të policisë, 2016-2021

Arrestimet e kohëve të fundit nuk janë diçka e pazakontë. Shifrat e pesë viteve të fundit tregojnë se kundër oficerëve të Policisë së Kosovës janë ngritur rreth 100 padi penale çdo vit, të cilat kanë rezultuar në pezullimin dhe madje arrestimin e disa oficerëve.¹⁹

Çdo vit midis viteve 2016-2021 është hetuar rreth 2,7% e personelit të Policisë së Kosovës. 38% e këtyre hetimeve kanë qenë për vepra penale, ndërsa 62% kanë qenë shkelje të disiplinës.

Që prej vitit 2019, numri i ankesave që i paraqiten IPK-së është rritur dukshëm. Në vitin 2021, janë paraqitur më shumë se 2 000 të tilla. Kjo rritje vjen kryesisht si pasojë e rritjes së vetëdijes së publikut për nevojën e raportimit të rasteve dhe rritjes së besimit tek IPK-ja si dhe për shkak të rritjes së veprimtarisë dhe gjobave të policisë në lidhje me pandeminë “kovid-19”.

Nga viti 2016 deri në vitin 2021, Departamenti për Menaxhimin e Ankesave dërgoi 3 535 raste në Departamentin e Hetimeve, nga të cilat vetëm 29% u përcollën me hetime penale, 48% u transferuan Policisë së Kosovës për hetime administrativo-disiplinore, ndërsa 23% u hetuan paraprakisht përpara se të transferoheshin vitin e radhës. Kjo ka dy pasoja: Së pari, të paktën 48% e ankesave/rasteve të transferuara nga Departamenti për Menaxhimin e Ankesave nuk plotësonin kushtet për hetim penal ose janë hedhur poshtë nga Departamenti i Hetimit. Së dyti, IPK-ja ka realizuar hetime për vepra penale në më pak se 20% të ankesave që ka pranuar.²⁰ Më tej, ia vlen të theksojmë që hetimet e realizuara kundër oficerëve të Policisë së Kosovës rrallë kanë të bëjnë me ryshfetin. Përkundrazi, në bazë të shifrave të



Operacioni në Vermicë-Morinë, pika e përbashkët e kalimit kufitar midis Kosovës dhe Shqipërisë.

Foto: Inspektorati Policor i Kosovës

periudhës 2019-2021, shumica e ankesave janë ngritur për shkak të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit

zyrtar dhe të lëndimeve të lehta trupore dhe keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare.²¹




Figura 1 Numri i oficerëve të Policisë, të hetuar dhe të dënuar, 2016-2021.

Burimi: Inspektorati Policor i Kosovës




Figura 2 Ankesat kundër oficerëve të policisë dhe numri i të hetuarve si pasojë e ankesave, 2016-2021.

Burimi: Inspektorati Policor i Kosovës

Mesatarisht, 13% e oficerëve të hetuar janë nga Departamenti i Kufirit, ndërsa 80% nga Departamenti i Operacioneve. Ia vlen të përmendim se shumica (76%) e të hetuarve janë oficerë të nivelit të ulët, ndërsa vetëm 10% janë rreshterë. Kjo tregon se subjekt hetimi janë kryesisht zyrtarët e nivelit të ulët të hierarkisë së policisë.²²

Hapat për forcimin e integritetit

Dy rastet e fundit që çuan në arrestimin e 5% të zyrtarëve të policisë kufitare të Kosovës lënë të kuptohen disa gjëra. Së pari, duket se ekziston një kulturë marrjeje ryshfeti në radhët e zyrtarëve të policisë kufitare, çka dobëson besimin e publikut te Policia dhe mbështetjen ndaj saj. Edhe pse pjesa më e madhe e ryshfeteve ishin të vogla për nga shumica, në të shkuarën ka pasur raste më serioze të bashkëpunimit me grupe kriminale.

Së dyti, sistemi i brendshëm i hetimit duket se punon mirë: IPK-ja punoi me efikasitet dhe në bashkëpunim të

ngushtë me shërbimet e tjera, duke përfshirë edhe ato të Shqipërisë. Ndonëse IPK-ja meriton mbështetje të mëtijshme në blerjen e pajisjeve dhe mjeteve hetimore, më shumë vëmendje duket t'i kushtohet parandalimit, sidomos nëpërmjet forcimit të integritetit në radhët e brezit të ri të personelit të zbatimit të ligjit.

Mund të ketë hapësirë më të madhe për përdorimin e teknologjinë në drejtim të forcimit të integritetit dhe profesionalizimit të policisë kufitare. Puna aktuale në hartimin e ligjit për pagat në sektorin publik dhe me ndryshimin e ligjeve për Policinë dhe Inspektoratin Policor, do duhej të ju ofronte paga konkurruese zyrtarëve të Policisë dhe të Inspektoratit Policor si dhe masa për përmirësimin e reputacionit, trajnime, llogaridhënies dhe integritetit të policisë. Në gjë e tillë do të ndihmonte për të siguruar që Policia e Kosovës të vazhdojë të jetë një prej institucioneve më të respektuara në vend. Kështu, burimet nuk do të përdorshin për të monitoruar policinë, por kriminelët.

Shënime

1. Policia e Kosovës, Raporti vjetor i punës i policisë së Kosovës, https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2022/03/RAPORTI-VJETOR-I-PUN%C3%8BS-I-POLICIS%C3%8BS-%C3%8B-KOSOV%C3%8BS_shqip.pdf.
2. UNDP Kosovo, *Public Pulse Brief XXI*, nëntor 2021, https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/democratic_governance/public-pulse-brief-xxi.html.
3. Kosovar Centre for Security Studies, *Citizen perceptions of integrity of public institutions in Kosovo*, Western Balkans Security Barometer Survey in Kosovo, janar 2022, https://qkss.org/images/uploads/files/Barometer_2021Kosovo_1_ENG%281%29_%281%29.pdf
4. Ministria e Punëve të Brendshme, *Number of employees at MIA*, 2022; Inspektorati Policor i Kosovës, *Raporti vjetor 2021*, <https://ipk.rks-gov.net/Medias/Raporti-Vjetor-2021-IPK-AL-35e2d7f9-41f5-4c66-9294-56c2306b85ff.pdf>.
5. Pika e kalimit kufitar në Qafë Prush lidh rajonin e Gjakovës në Kosovë me Bajram Currin në Shqipëri, ndërkohë që pika e kalimit kufitar në Qafë Morinë lidh rajonin e Gjakovës me Kukësin dhe Krumën në Shqipëri.
6. Walter Kemp, Kristina Amerhauser dhe Ruggero Scaturro, *Spot Prices: Analyzing flows of people, drugs and money in the Western Balkans*, GI-TOC, maj 2021, https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/05/Hotspots3_PR_AL.docx.
7. Intervistë me një zyrtar të IPK-së, 21 prill 2022.
8. Po aty.; IPK, Operacioni "Pika" vë në pranga 48 zyrtarë policorë dhe 2 (dy) zyrtarë doganorë të dyshuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe marrje të ryshfetit, 14 mars 2020, <https://www.facebook.com/InspektoratiPolicoriKosoves/posts/pfbid02Ti91dxaPhiGr9Jh2J5kyV7WuLZQhfVnf4HpCfKfZYg1CE851uRTg5jswoCb1P6Epl>.
9. IPK, Operacioni 'Pika' vë në pranga 48 zyrtarë policorë dhe 2 (dy) zyrtarë doganorë të dyshuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe marrje të ryshfetit, 14 mars 2020, <https://www.facebook.com/InspektoratiPolicoriKosoves/posts/pfbid02Ti91dxaPhiGr9Jh2J5kyV7WuLZQhfVnf4HpCfKfZYg1CE851uRTg5jswoCb1P6Epl>.
10. Po aty.
11. *Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë për forcimin e bashkëpunimit në fushën e kontrollit të brendshëm*, 23 mars 2015, <https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2021/04/Memorandum-bashk%C3%ABpunimi-n%C3%AB-mes-t%C3%AB-MPB-t%C3%AB-Republik%C3%ABS-s%C3%AB-Kosov%C3%ABS-dhe-MPB-t%C3%AB-Republik%C3%ABS-s%C3%AB-Shqip%C3%ABris%C3%AB-mbi-forcimin-e-bashk%C3%ABpunimit-n%C3%AB-fush%C3%ABn-e-kontrollit-t%C3%AB-brendsh%C3%ABm.pdf>.
12. IPK, IPK nënshkruan protokoll për inspektim të përbashkët në mes të IPK-së dhe SHÇBA-së të Shqipërisë, 15 prill 2016, <https://m.facebook.com/media/set/?vanity=118093578321087&set=a.815137638616674>.
13. Intervistë me një zyrtar të IPK-së, 21 prill 2022.
14. IPK, Operacioni 'Pika 2' vë në pranga 26 zyrtarë policorë të dyshuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe marrje të ryshfetit, 8 prill 2022, <https://www.facebook.com/InspektoratiPolicoriKosoves/posts/pfbid02XHrdj5JtNmH3XCXsYnPs515T7AqrH95GSioNWivNnr1peydABpy6Grey3d1U51Bol>.
15. Aksioni në Morinë/ Evidentohen 312 raste korruptive, SPAK çon në burg 17 policë, pezullohen 3 të tjerë, Top Channel, 8 prill 2022, <https://top-channel.tv/2022/04/08/korrupsion-dhe-kontrabandene-kufirin-shqiperi-kosove-spak-njoftim-zyrtar-arrest-me-burg-per-17-police1/>.
16. 'Do qesësh kafe', zbardhen përgjimet e policëve, TV Klan, 10 prill 2022, <https://www.youtube.com/watch?v=XqIkTtwk70>.
17. Intervistë me një zyrtar të IPK-së, 21 prill 2022.

18. IPK, *Annual Reports for 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 and 2021*, <https://ipk.rks-gov.net/Reports/AnnualReports>.
19. *Detaje nga arrestimi i 59 zyrtarëve policorë për marrje ryshfeti [Raport i KTV-së]*, *Koha Ditore*, 19 dhjetor 2016, <https://archive.koha.net/?id=3&l=148072>.
20. IPK, *Raportet vjetore 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 and 2021*, <https://ipk.rks-gov.net/Reports/AnnualReports>.
21. IPK, *Raportet vjetore 2019, 2020 and 2021*, <https://ipk.rks-gov.net/Reports/AnnualReports..>
22. Policia e Kosovës, *Decisions for disciplinary measures 2016–2021*, Email, 21 prill 2022.

Rritet popullariteti i rrugëve detare për trafikimin përmes Ballkanit.

Rajoni i Ballkanit është urë natyrore ku zhvillohet tregtia e ndërsjellë midis Afrikës dhe Azisë nga njëra anë dhe Evropës nga ana tjetër. Historikisht, tregtia në rajon është kryer kryesisht nëpërmjet rrugëve tokësore. Por ai që rrallë merret parasysh është fakti që ka një numër portesh relativisht të mëdha përgjatë bregdetit të Detit Adriatik, Detit Jon, Detit Egje dhe Detit të Zi, si dhe përgjatë Danubit.

Pjesa dërmuese e infrastrukturës së këtyre porteve u dëmtua me rënien e komunizmit dhe me luftërat në Jugosllavi në vitet 1990 dhe, më vonë, nga kriza financiare e vitit 2008. Megjithatë, rritja e investimeve, sidomos nga Bashkimi Evropian dhe Kina, po e përmirëson infrastrukturën e porteve në rajon, duke rritur kështu madhësinë dhe efikasitetin e porteve të anijeve të kontejnerëve dhe të lidhjeve rrugore dhe

hekurudhore që nevojiten për t'i sjellë mallrat në tregje të ndryshme. Rastet kryesore të sekuestrimit të drogës dhe cigareve në portet rajonale gjatë disa viteve të fundit tregojnë se këta faktorë po i bëjnë këto porte më tërheqëse edhe për zhvillimin e kontrabandës drejt Ballkanit Perëndimor.

Rritja e sasisë së kokainës, heroinës dhe drogave sintetike

Siç është analizuar në hulumtime të mëparshme të GI-TOC-së, grupet kriminale nga Ballkani Perëndimor merren me kontrabandim droge — sidomos kokaine — nga Amerika Latine drejt Evropës perëndimore, në anije kontejnerësh dhe në jahte. Në Evropën juglindore, tipi kryesor i “krimit blu” (d.m.th. ekonomia kriminale detare) është trafikimi i kokainës dhe heroinës.¹




Figura 1 Prurjet e paligjshme nëpërmjet rrugëve detare të Ballkanit.

Burimi: Ruggero Scaturro dhe Walter Kemp, Portholes: Exploring the maritime Balkan routes GI-TOC, korrik 2022,

<https://globalinitiative.net/analysis/balkans-maritime-routes-ports-crime/>

Afërsia e rajonit me tregjet konsumatore të mëdha dhe joshëse të Evropës Perëndimore, lidhjet e tij me Afrikën e Veriut dhe me Turqinë, si dhe rritja e vëllimit tregtar nga Amerika Latine dhe Azia, të gërshetuara me

dobësitë që paraqet korrupsioni, krijojnë kushtet ideale ku rrjetet kriminale mund të merren me këtë lloj trafikimi. Që t'i japim lexuesit një ide për sasinë për të cilën bëhet fjalë, gjatë periudhës 2018-2021, në portet e Ballkanit

KRIMI BLU NË DANUB: PRURJE TË PALIGJSHME DREJT ZEMRËS SË EVROPËS?

Ndryshe nga portet detare tregtare, shumica e mallrave që lëvizin përgjatë Danubit ruhen në sasi të mëdha dhe transportohen në varka, çka e bën të vështirë inspektimin. Për të parë nëse fshihet ndonjë gjë brenda, duhet të shposh me ndonjë shufër metalit materialet, p.sh. rërë ose zhavorr. Ose një pjesë e mallrave duhet të shkarkohen, gjë që zgjat shumë kohë dhe paraqet vështirësi nga pikëpamja logjistike. Në nëntor të vitit 2021, Administrata Kombëtare Hungareze e Tatimeve dhe Doganës konfiskoi

një dërgesë rekord prej 57 milionë cigaresh të patakuaara, të cilat ishin fshehur poshtë thasëve të kripës në një varkë që vinte nga Ukraina.⁷

Në figurën 2 tregohet se shtrirja e trafikimit të mallrave në varka në lumin e Danubit duket se nënvlerësohet nga zyrtarët e zbatimit të ligjit, duke qenë se zbulimet më të mëdha të rasteve të kontrabandës kanë ndodhur rastësisht.




Figura 2 Shembuj të kontrabandimit përgjatë Danubit.

Burimi: Ruggero Scaturro dhe Walter Kemp, Portholes: Exploring the maritime Balkan routes, GI-TOC, korrik 2022,

<https://globalinitiative.net/analysis/balkans-maritime-routes-ports-crime/>

Lufta në Ukrainë mund të krijojë mundësi të reja për kontrabandimin e mallrave të ligjshme (p.sh. karburanti) dhe të paligjshme (p.sh. armë dhe drogë). Për këtë arsye, bashkëpunimi në mbarë rajonin e Danubit dhe të Detit të

Zi kërkon vëmendje të menjëhershme dhe bashkëpunim më të ngushtë midis shteteve, duke përdorur autoritete ekzistuese si p.sh. Komisioni i Danubit, Europoli dhe Qendra për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore.

Perëndimor, u sekuestruan rreth 8 tonë kokainë, ku gjysma u sekuestrua në portin e Pireut (Greqi), Durrësit (Shqipëri) dhe Konstancës (Rumani).² Megjithatë, kokaina nuk është e vetmja drogë që hyn në këtë rajon përmes porteve. Në portet rajonale sekuestrohen rregullisht edhe sasi heroine dhe, së fundmi, edhe droga sintetike.³

Në figurën 1 tregohet se heroina hyn në rajon nëpërmjet dy porteve kryesore: Varnës (Bullgari) dhe Koperit (Slloveni). Porti i Varnës është edhe pikë hyrjeje nga Deti i Zi për të kaluar te rruga tokësore tradicionale ballkanike dhe, më pas, në Evropën Perëndimore. Për shembull, në shkurt të vitit 2021, zyrtarët e doganës bullgare konfiskuan më shumë se 400 kilogramë heroinë në një anije që transportonte mallra nga Irani. Droga ishte ndarë në 487 pako, të fshehura në mes të rrotullave të asfaltit që ishin ngarkuar në anije. Kjo dërgesë, me shumë mundësi, ishte mjaft e madhe për tregun bullgar.⁴ Porti i Koperit, nga ana tjetër, është pikë ideale hyrjeje për rrjetet që mundohen të shmangin kapërcimin e Ballkanit në rrugë tokësore. Anijet me kontejnerë vijnë nga Turqia dhe Irani duke shmangur gjithë rajonin dhe dërgohen drejt e te portat e Evropës Perëndimore. Në bazë të informacioneve rreth operacioneve të policisë kundër drogës në portin e Koperit, del se autoritetet sllovene kanë konfiskuar më shumë se një ton heroinë gjatë katër viteve të fundit.⁵

Në portet rajonale po rritet numri i rasteve të sekuestrimit të drogave sintetike të destinuara për tregjet evropiane. Amfetamina nga Siria, Sri Lanka dhe India, të nisura drejt Evropës ose Libisë, fshihen në mënyra të ndryshme, p.sh. futen në kontejnerë me çarçafë, batanije dhe peshqirë. Ato që përbëjnë shqetësim të veçantë për autoritetet janë amfetaminat "kaptagon", të cilat quhen ndryshe edhe "droga e xhihadistit". Për shembull, në vitin 2019, në tri anije kontejnerësh që vinin nga Siria dhe ishin nisur për në Kinë nëpërmjet portit të Pireut u gjetën 23 milionë hape kaptagoni.⁶

Aktorët kriminalë vendorë dhe të huaj

Nëse përdorim klasifikimin që përdoret në Indeksin Global të Krimit të Organizuar të GI-TOC-së, aktorët kriminalë që mund të shfrytëzojnë rrugët detare në Ballkan mund t'i ndajmë në katër tipa: rrjete kriminale, aktorë të lidhur me shtetin, grupet e stilit mafioz dhe aktorë të huaj.⁸ Rrjetet kriminale janë të pranishme në porte të tilla si portet e Koperit, Rijekës dhe Ploçës, ku veprojnë herë pas here celula të atij që Europolli dhe mediet e quajnë "kartel Ballkanik". Një prej avantazheve

kryesore të kësaj shoqate kriminale është mungesa e pengesave gjuhësore dhe kulturore midis boshnjakëve, kroatëve, malazezëve dhe serbëve.

Me termin "aktorë të lidhur me shtetin" që përdoret në Indeks, nënkuptohen aktorët kriminalë që veprojnë nga brenda aparatit shtetëror. Historikisht, porti i Barit është njohur si portali evropian për kontrabandimin e cigareve, tregti kjo që është mbështetur dhe lehtësuar nga zyrtarët të nivelit të lartë dhe elitat politike. Një tjetër shembull është Varna, ku skandalet e korrupsionit, pretendimet për abuzime me fondet dhe për pastrim parash janë elemente që karakterizojnë historinë e kohëve të fundit të administratës portuale.

Së treti, "grupet e stilit mafioz" janë grupe kriminale që kanë drejtues të përcaktuar dhe kontroll mbi një territor. Në Evropën Juglindore (EJL), portet tregtare si ata të Barit, Durrësit dhe Rijekës, bëjnë pjesë në zonën tradicionale të ndikimit kriminal, e cila mbulohet nga grupe lokale të mirëpërcaktuara të stilit mafioz.

Së katërti, termi "aktorë të huaj" nënkupton aktorët kriminale që veprojnë jashtë vendit të tyre dhe përfshijnë grupet në diasporë të cilët kanë hedhur rrënjë në vende të tjera ndër breza. Kjo e dhënë e fundit çon peshë sidomos për portet greke të Pireut dhe Selanikut, ku raportohet se shqiptarët etnikë, me pasaporta greke, kontrollojnë pjesën më të madhe të tregut të kokainës. Në varësi të komoditetit të paligjshëm, si shembuj të tjerë të aktorëve të huaj që janë aktiv në rrugët detare të Ballkanit mund të përmendim edhe grupet kriminale italiane në Rijekë dhe Pire, malazezët dhe serbët në Koper, serbët në Konstancë dhe serbët e turqit në Varnë. Në fakt, portet e fundit janë magnet për grupet kriminale që veprojnë në shtetet e rrethuara nga toka në Ballkanin Perëndimor.

Përqendrimi te prurjet

Shqetësimet për trafikimin në rrugë detare priren të çojnë në rritjen e sigurisë në porte. Megjithatë, ndërtimi i gardheve më të larta dhe instalimi i më shumë skanerëve dhe kamerave nuk janë tjetër veçse një pjesë e zgjidhjes. Tregtia që realizohet me anë të anijeve kontejnerësh zakonisht është ndërkombëtare. Mallrat e paligjshme që transportohen drejt Evropës Juglindore me anije kontejnerësh shpesh vijnë nga larg, p.sh. nga Amerika Latine, Afrika e Veriut ose Azia. Prandaj, për ta kuptuar dhe goditur tregtinë e paligjshme, për realizimin e së cilës përdoren rrugë dhe modalitete të ligjshme, lipset të ketë bashkëpunim ndërkombëtar. Portet duhet të shihen

si hallka të një zinxhiri më të madh, dhe jo thjesht si pika të izoluar.

Qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë bërë hapa të mëdhenj përpara gjatë 20 vjetëve në drejtim të përmirësimit të sigurisë portuale, në përputhje me Kodit Ndërkombëtar të Sigurisë së Anijeve dhe Porteve (NSAP), falë mbështetjes ndërkombëtare të organizatave si Zyra e OKB-së për Drogën dhe Krimin, Europoli dhe ndihma dypalëshe. Megjithatë, masat që parashikohen në kodin NSAP dhe që mund të ulin disa prej rreziqeve të veprimtarive kriminale, nuk u kushtojnë vëmendje prurjeve të mallrave me anije kontejnerësh, edhe pse në këto anije përqendrohet pjesa më e madhe e veprimtarive kriminale.¹⁷

Tani për tani, ka bashkëpunim të pamjaftueshëm në radhët e ofruesve të shërbimit të sigurisë brenda dhe midis porteve, për shembull midis agjencive doganore. Ky bashkëpunim mund të përmirësohet duke krijuar grupe pune të përbashkëta ose njësi të përbashkëta për kontrollin e portit, duke angazhuar zyrtarët e ndërlidhjes (nga vendet fqinje, vendet furnizuese dhe/ose organizatat përkatëse ndërkombëtare) dhe duke

përdorur në mënyrë më efektive teknikat e hetimit special.

Më tej, ka një mospërputhje midis atyre që janë përgjegjës për sigurinë portuale dhe agjencive ligjzbatuese që merren me krimin e organizuar. Kjo mund të zgjidhet duke u përqendruar më shumë te siguria detare, në kuadër të vlerësimeve të kërcënimeve nga krimi i organizuar; duke shkëmbyer informacione për teknikat e fshehjes dhe ndalimit, si dhe për grupet kriminale që veprojnë në rrugët detare të Ballkanit; duke bashkëndarë të rejtat më të fundit rreth prodhimit të drogës dhe mekanizmave të furnizimit; dhe duke vënë në dispozicion raporte përmbledhëse rreth prirjeve tregtare dhe mënyrës se si këto mund të ndikojnë te veprimtaritë e paligjshme. Gjithashtu, mund të jetë e dobishme të krijohet një bazë e përbashkët të dhënash, me qëllim gjurmimin e sekuestimeve, arrestimeve dhe aktorëve kriminalë që veprojnë në rrugët detare të Ballkanit.

Kur në një port ka korrupsion, as sistemi më i mirë në botë i sigurisë nuk ka kurrfarë dobie. Prandaj, është e rëndësishme që të merren masa për forcimin e

SHITJA E CIGAREVE NGA PORTI I BARIT

Përmes portit të Barit kontrabandohen më shumë se dy miliardë cigare, gjë që çon në humbjen e 300 milionë eurove tarifa doganore dhe akcizë.⁹ Në kuadër të fushatës për ndalimin e kontrabandimit të cigareve, në korrik të vitit 2021, qeveria malazeze ndaloj ruajtjen e produkteve të duhanit në zonën e lirë të portit.¹⁰ Për pasojë, tani një hangar i tërë është plot me cigare.¹¹ Duke qenë se pronarët nuk erdhën për t'i marrë cigaret në maj të vitit 2022 (që ishte afati i planifikuar nga qeveria), dogana sekuestroi më shumë se 140 000 paketa cigaresh që kapin vlerën e mbi 60 milionë eurosh në tregun e paligjshëm.¹² Pyetja tani është se çfarë do bëhet me to.

Qeveria e Malit të Zi po planifikon t'u japë pronarëve një mundësi të fundit (deri në shtator të vitit 2022) që të vijnë dhe të marrin produktet e duhanit dhe të paguajnë taksën e shtetit (30 qindarka për çdo paketë cigaresh, 10 euro për kilogram duhani të prerë dhe 10 euro për kilogram esence për nargjile). Në të njëjtën kohë, qeveria ka hartuar një ligj që do t'i mundësojë t'i shesë cigaret dhe të nxjerrë 15-20 milionë euro të ardhura në rast se

pronarët nuk vijnë për të marrë mallin dhe nuk paguajnë taksën brenda afatit.¹³


Ky propozim ka shkaktuar kritika nga komuniteti ndërkombëtar, duke përfshirë edhe Organizatën Botërore të Shëndetësisë, e cila ka argumentuar se cigaret e konfiskuara duhet të shkatërrohen.¹⁴ OBSH-ja ka deklaruar se hedhja në treg e cigareve të sekuestruara nuk është në përputhje me protokollin "Për eliminimin e tregtisë së paligjshme të produkteve të duhanit", të cilin Mali i Zi e ratifikoi në vitin 2017.¹⁵ Organizata vë në dukje se e drejta ndërkombëtare duhet të marrë përparësi ndaj të drejtës së vendit dhe se miratimi i këtij ligji do të përbënte shkelje të këtij parimi dhe do të çonte në lëvizjen e pakontrolluar të cigareve të sekuestruara.¹⁶

Paradoksi këtu qëndron në faktin që, edhe pse po përpiqet të bëjë gjënë e duhur duke goditur kontrabandën e cigareve, qeveria e Malit të Zi e ka futur veten midis dy zjarresh.

integritetit. Digitalizimi mund të ulë rastet e korrupsionit, por ekziston mundësia që të ketë infiltrime në programet kompjuterike me qëllim uljen e mundësisë së zbulimit të mallrave që janë fshehur në kontejnerë. Deri më tani, inteligjenca artificiale nuk ka përparuar deri në atë pikë sa të zëvendësojë zyrtarët me përvojë të

doganave dhe të agjencive ligjzbatuese që mund të nuhasin kërcënimin kur bëjnë analizat e kërcënimit. Me një fjalë, teknologjia duhet të konsiderohet si aset i mundshëm për përmirësimin e sigurisë në porte, por jo si ilaç që i shëron të gjitha sëmundjet.

Ky artikull mbështetet në kërkimin e bërë në kuadër të studimit *Portholes: Exploring the maritime Balkan routes*, studim i ri ky, i realizuar për GI-TOC-në nga Ruggero Scaturro dhe Walter Kemp dhe i botuar në korrik të vitit 2022. Mund ta gjeni në: <https://globalinitiative.net/analysis/balkans-maritime-routes-ports-crime/>.



Shënime

1. Walter Kemp, *Transnational tentacles: Global hotspots of Western Balkan organized crime*, GI-TOC, korrik 2020, https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2020/07/Transnational-Tentacles-Global-Hotspots-of-Balkan-Organized-Crime-ALBANIAN_MRES.pdf; SIPRI, *The Black Sea: Engaging in dialogue and combatting nuclear smuggling*, <https://www.sipri.org/research/conflict-peace-and-security/europe/black-sea-engaging-dialogue-and-combatting-nuclear-smuggling>; Ben Crabtree, *Black Sea: A rising tide of illicit business?*, GI-TOC, 1 prill 2020, <https://globalinitiative.net/analysis/black-sea-illicit-flows/>.
2. Shih për shembull: *Albania seizes 613 kilos of Colombia cocaine, holds two*, Reuters, 28 shkurt 2018, <https://www.reuters.com/article/us-albania-cocaine-idUSKCN1GC2KY>; *Romania seizes record 2.5 tons of Colombian cocaine, 5 held*, Reuters, 1 korrik 2016, <https://www.reuters.com/article/us-colombia-drugs-romania-idUSKCN0ZH4X1>; Hellenic Republic Ministry of Citizen Protection, *Κατασχέθηκαν -35- κιλιά κοκαΐνης σε εμπορευματοκιβώτιο στο λιμάνι του Πειραιά*, 23 dhjetor 2020, http://www.astynomia.gr/index.php?option=ozo_content&lang=%27..%27&perform=view&id=99409&Itemid=2565&lang.
3. Intervistë me një ekspert për kontrollin dhe sigurinë e kontejnerëve në EIJL, dhjetor 2021.
4. Associated Press, *Bulgarian prosecutors say heroin found in cargo from Iran*, ABC News, 16 shkurt 2021, <https://abcnews.go.com/International/wireStory/bulgarian-prosecutors-heroin-found-cargo-iran-75923810>.
5. T R, *Še pomnite zaseg 300 kg heroína v luki Koper? Tožilstvo spisalo obtožbo, dvojica še vedno na begu*, Regional, 10 shtator 2019, <https://www.regionalobala.si/novica/se-pomnite-zaseg-300-kg-heroína-v-luki-koper-tožilstvospisalo-obtožbo-dvojica-se-vedno-na-begu>; Ministry of the Interior of the Republic of Slovenia, *The biggest seizure of heroin in Slovenia result of the cooperation of the Slovene and Hungarian police units and financial administration*, 13 nëntor 2019, <https://www.policija.si/eng/newsroom/news-archive/101619-the-biggest-seizure-of-heroin-in-slovenia-result-of-the-cooperation-of-the-slovene-and-hungarian-police-units-and-financial-administration-press-release>; dhe R K, V *Luki Koper zasegli več kot 200 kilogramov heroína*, Siol, 16 qershor 2021, <https://siol.net/novice/slovenija/v-luki-koper-zasegli-vec-kot-200-kilogramov-heroína-554783>.
6. *Piraeus counterfeit Captagon amphetamine haul in the millions*, Ekathimerini, 2 korrik 2019, <https://www.ekathimerini.com/news/242107/piraeus-counterfeit-captagon-amphetamine-haul-in-the-millions/>.
7. Dajkó Ferenc Dániel, *A tapasztalt nyomozók is megdöbbentek a csempészciigi mennyiségén - videó a cikkben*, Növekedés, 10 nëntor 2021, <https://novekedes.hu/nav-infotar/a-tapasztalt-nyomozok-is-megdobbentek-a-csempeszciigi-mennyisegen-video-a-cikkben>.
8. Për më shumë informacione në lidhje me Indeks Global të Krimin të Organizuar, vizitoni faqen: <https://globalinitiative.net/analysis/ocindex-2021/>.
9. *Preko Luke Bar se prokrijumčari više od 2 milijarde cigareta*, RTCG, 23 mars 2022, https://www.rtcg.me/vijesti/crna_hronika/356456/preko-luke-bar-se-prokrijumcari-vise-od-2-milijarde-cigareta.html.
10. *Informacija o potrebi pokretanja postupka isključenja ili zabrane skladištenja duvanskih proizvoda iz oblasti Slobodne zone Luke Bar*, Vlada Crne Gore, 1 korrik 2021, <https://www.gov.me/dokumenta/330dabd9-4bf3-4c86-ae35-953aef0c908f>; *Informacija o potrebi pokretanja postupka isključenja ili zabrane skladištenja duvanskih proizvoda iz oblasti Slobodne zone Luke Bar - zaključci*, Vlada Crne Gore, 22 korrik 2021, <https://www.gov.me/dokumenta/f712b171-b04c-4434-bc40-22e3032edb6d>.

11. Intervistë me një oficer të sigurisë portuale në Tivar, Mali i Zi, dhjetor 2021.
12. Jelena Jovanović dhe Biljana Matijašević, *Plijene milionski vrijedne cigarete iz Luke Bar*, 14 maj 2022, <https://www.vijesti.me/vijesti/crna-hronika/604097/plijene-milionski-vrijedne-cigarete-iz-luke-bar>.
13. Intervistë me një gazetar investigativ në Podgoricë, Mali i Zi, korrik 2022.
14. 'Očekujemo da Crna Gora uništi ili ukloni cigarete zaplijenjene u Luci Bar', RTCG, 27 korrik 2022, <https://www.rtcg.me/vijesti/ekonomija/371918/ocekujemo-da-crna-gora-uništi-ili-ukloni-cigarete-zaplijenjene-u-luci-bar.html>.
15. Framework Convention on Tobacco Control, *Protocol to eliminate illicit trade in tobacco products*, World Health Organization, 2013, <https://fctc.who.int/publications/i/item/9789241505246>.
16. Intervistë me një përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare në Podgoricë, Mali i Zi, korrik 2022. Shih edhe: Predrag Tomović, *Prodaja zaplijenjenih cigareta komplikuje evropske integracije Crne Gore*, Radio Slobodna Evropa, 28 korrik 2022, <https://www.slobodnaevropa.org/a/zaplijenjene-cigarete-prodaja-crna-gora-sverc/31963479.html>.
17. Intervistë online me menaxherin e sigurisë portuale për një port të SHBA-së, tetor 2021.

Rrogat e ulëta të oficerëve të policisë në Ballkanin Perëndimor rrezikojnë të çojnë në rritjen e korrupsionit në radhët e tyre.

Roli kryesor i policisë në një vend demokratik është të ruajë rendin dhe qetësinë publike, të parandalojë dhe luftojë krimin dhe t'u shërbejë qytetarëve me taksat e të cilëve paguhet siguria publike. Policia ofron një shërbim që shpesh është i rrezikshëm dhe mund të përfshijë edhe punën me orar të zgjatur në kushte të vështira. Kjo punë ka ndikim të madh negativ te shëndeti mendor i oficerëve të policisë. Për kryerjen e saj, duhen rezistencë dhe gjykim i shëndoshë dhe një nivel i lartë përgjegjësie kur bëhet fjalë sidomos për përdorim të forcës vdekjeprurëse.

la vlen të përmendet se, ndonëse popujt në Ballkanin Perëndimor shohin vend për përmirësim në aspektin e drejtësisë penale (ku përfshihet edhe lufta kundër krimit të organizuar),¹ ata kanë mendim relativisht të mirë për policinë.² Është normale të mendosh që ata që janë përgjegjës për sigurinë e qytetarëve duhet të marrin rrogë që është e arsyeshme, që i përgjigjet kostos së jetesës dhe që është tërheqëse për individët profesionistë dhe të motivuar dhe e mjaftueshme për të nxitur kënaqësinë nga puna. Megjithatë, rrogat e oficerëve të policisë në Ballkanin Perëndimor, në realitet, nuk përputhen me këtë pritshmëri.

Nuk është gjithmonë e lehtë të gjesh rrogat e policisë në vendet e Ballkanit Perëndimor. GI-TOC-ja ka mbledhur dhe përpiluar informacionet e mëposhtme duke u mbështetur në burime të ndryshme. Këto informacione janë hamendësimi më i mirë që mund të bëjmë duke marrë për bazë të dhënat e disponueshme (kryesisht ato të vitit 2021). Për t'i bërë krahasimet më të lehta, rrogat janë paraqitur në euro dhe në vlerën neto, pas tatimit dhe zbritjes së përfitimeve. Nuk ka dallim në nivelin e rrogave të oficerëve gra dhe burra të policisë në asnjë prej gjashtë vendeve të rajonit, sepse rroga lidhet gjithmonë me pozicionin e punës brenda strukturës së policisë (dhe jo me gjininë).

Për t'i kuptuar më mirë këto rroga, duhet marrë parasysh që rroga minimale në Mal të Zi në vitin 2021 raportohet se është 532 euro, në Maqedoninë e Veriut 360 euro, ndërsa në Serbi 400 euro. Në vitin 2020, rroga mesatare në Kosovë ishte 416 euro,⁶ ndërsa rroga minimale e policisë në vitin 2021 ishte 447 euro. Kushtet janë edhe më pak tërheqëse në Shqipëri, ku në vitin 2021 rroga minimale e policisë ishte 18% më e ulët sesa paga mesatare në vend.⁷ Situata në Bosnjë dhe Hercegovinë ishte edhe më keq: aty rroga minimale e policisë ishte 30% më e ulët sesa mesatarja për vitin 2019.⁸ Me rritjen e çmimeve, paga

Vendi	Numri i qytetarëve	Numri i punonjësve të Ministrisë së Punëve të Brendshme	Numri i oficerëve të policisë (me autoritetin e zbatimit të ligjit)	Rrogat e policisë		Numri i oficerëve të policisë për çdo 100 000 banorë
				Oficeri i policisë i ri/i nivelit të ulët	Oficeri i policisë i vjetër/i nivelit të lartë	
Shqipëria	2 846 000	15 109	11 802	€406	€1 401	260
Bosnja dhe Hercegovina	3 281 000	19 140 ³	15 777 ⁴	€340-460	€511 ⁵	481
Kosova	1 873 000	10 600	8 104	€447-541	€569-1 761	464
Mali i Zi	621 873	721	4 680	€396	€1 353	502
Maqedonia e Veriut	2 083 000	12 599	9 953	€380-450	€360-1 380	341
Serbia	8 737 000	41 438	31 313	€440	€2 296	435

Figura 1 Oficerët e policisë dhe nivelet e përlogaritura të rrogave në vendet e Ballkanit Perëndimor (2021).

Burimet: Raportet e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2021

minimale shpesh nuk mjafton për të mbuluar nevojat bazë të një familjeje mesatare. Me pak fjalë, rroga bazë e një oficeri policor në shumicën e vendeve të rajonit nuk është tërheqëse.

Për krahasim, rroga mesatare mujore e oficerëve të policisë në Rumani⁹ ose Slloveni është rreth 1 000 euro në muaj,¹⁰ ndërsa rroga bazë e oficerëve të policisë në Hungari është fare pak më e lartë sesa ajo e homologëve të tyre në Ballkanin Perëndimor.¹¹

Rrogat rriten sipas pozitës, arsimit dhe viteve në shërbim. Oficerët mund të paguhen edhe për punë jashtë orarit normal të punës ose kur marrin përsipër detyra me rrezik. Në përgjithësi, rrogat për drejtuesit e rretheve policore janë sa dyfishi i rrogës minimale.

la vlen të thuhet se rrogat në përgjithësi janë më të ulëta për policinë kufitare dhe relativisht të larta për policët që punojnë në njësitë e luftës kundër krimit të organizuar. Për shembull, në Serbi (ku rrogat e policisë kanë pasur rritjen më të madhe në rajon), rroga mesatare për dikë që punon në drejtorinë e policisë kufitare është 807 euro në muaj, ndërsa rroga mesatare në njësinë e luftës kundër krimit të organizuar është 1 034 euro. Në Mal të Zi, shifrat janë: 562 euro në muaj për policinë kufitare dhe 784 euro për policët që punojnë në njësinë e luftës kundër krimit të organizuar.

Në përgjithësi, rroga e drejtorëve të policisë në gjithë rajonin luhet nga 1 200 euro në 1 700 euro në muaj. Është e vetëkuptueshme që drejtori i inspektoratit policor zakonisht merr një rrogë që i afrohet rrogës së nivelit të pozitës më të lartë në hierarkinë e policisë.

Rreziku i korrupsionit

Tek organizatat e policisë në Ballkanin Perëndimor është përhapur mendimi se oficerët paguhen më pak nga sa

duhet.¹² Strukturat e menaxhimit të policisë dhe sindikatat në të gjashtë vende po bëjnë presion për rritje rrogash me qëllim që të tërhiqen dhe mbahen rekrutët e mirë, të ruhet profesionalizmi i shërbimit të policisë dhe të ulët korrupsioni.

Edhe pse gjatë këtyre viteve të fundit ka pasur rritje rrogash, disa sindikata të policisë argumentojnë se ushtrimi i këtij profesioni është bërë më i rrezikshëm dhe se puna nuk shpërblehet sa duhet.¹³ Kjo i detyron oficerët e policisë të kërkojnë punë të tjera, më tërheqëse, për të mbajtur familjet. Ata mund të bëjnë edhe punë shtesë, p.sh. si punonjës sigurie në kompanitë e sigurimit. Megjithatë, ekziston rreziku që policët e nënpaguar dhe të pakënaqur mund të korruptohen më lehtë, të përfshihen në konflikte interesi ose të bëjnë marrëveshje të fshehta me grupet kriminale. Një numër rastesh të fundit—duke përfshirë ato në kufirin midis Kosovës dhe Shqipërisë, të cilat i kemi përmendur më lart në këtë buletin—sinjalizojnë dy elemente: korrupsionin e vogël dhe marrëveshjet me grupet kriminale (çka janë më serioze). Kjo vë në rrezik sigurinë e publikut dhe ia bjerr publikut besimin te policia.

Megjithatë, askush nuk duhet të nxitojë e të thotë që rrogat e ulëta ndikojnë te niveli i korrupsionit. Rrogat e larta, në vetvete, nuk mund të forcojnë integritetin. Oficerët e policisë kanë nevojë për kënaqësi nga puna, mundësi për ngritje në karrierë dhe mirënjohje për punën. Më tej, është e rëndësishme të zhvillohen trajnime në etikë dhe të krijohen mekanizma efektivë dhe efikas mbikëqyrjeje me qëllim nxitjen e integritetit. Rrogat e oficerëve të policisë duhet të jenë tërheqëse dhe t'u përgjigjen rreziqeve dhe përgjegjësi që ngërthen puna e tyre. Duke qenë se kriminelët e Ballkanit Perëndimor po modernizojnë teknikat dhe po përforcojnë kontaktet ndërkombëtare, edhe policia e këtij rajoni duhet të bëjë të njëjtën gjë.

Shënime

1. Regional Cooperation Council, *Balkan Barometer 2020, Public opinion*, prill 2020, https://www.rcc.int/download/docs/2020-06-Balkan-Barometer-Public-Opinion_final.pdf/bf27f9fc10de8a02df9db2b60596f0cd.pdf.
2. Center for Insights in Survey Research, *Western Balkans regional poll*, shkurt-mars 2020, https://www.iri.org/wp-content/uploads/2020/06/final_wb_poll_for_publishing_6.9.2020.pdf.
3. Të gjitha shifrat për Bosnjën dhe Hercegovinën janë të vitit 2019. Ky është numri i përgjithshëm i oficerëve të policisë në Ministrinë Federale të Sigurisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës Serbe, si dhe numri i oficerëve të policisë nga kantonet dhe nga policia gjyqësore.
4. Numër i përllogaritur i oficerëve të policisë, duke ndjekur raportin matematikor që jepet në Raportin e Progresit të vitit 2021 të KE-së për Bosnjën dhe Hercegovinën.
5. Shifrat për rrogat e policisë në Bosnjë dhe Hercegovinë janë të vitit 2019. *Policajci iz BiH se bune zbog malih plaća, uputili zahtjeve, evo koliku osnovicu traže*, Radio Sarajevo, 25 shkurt 2022, <https://radiosarajevo.ba/vijesti/bosna-i-hercegovina/policajci-iz-bih-se-bune-zbog-malih-placa-uputili-zahtjeve-evo-koliku-osnovicu-traze/448454>.
6. Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistika Sociale: Niveli i pagave në Kosovë 2020, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, <https://ask.rks-gov.net/media/6030/niveli-i-pagave-n%C3%AB-kosov%C3%AB-2020.pdf>.

7. Instituti i Statistikave i Shqipërisë, Statistikat e Pagave, Tremujore IV/2021, 10 mars 2022, http://www.instat.gov.al/media/9660/pagat_press_release-t4_-2021-altcom.pdf.
8. *Average Monthly Net Salary in Bosnia and Herzegovina is 945 BAM*, *Sarajevo Times*, 16 mars 2020, <https://sarajevotimes.com/average-monthly-net-salary-in-bosnia-and-herzegovina-is-945-bam/>
9. *Average Salary In Romania*, *Career Explorer*, 11 janar 2022, <https://careerexplorerguide.com/average-salary-in-romania/>.
10. *Police Officer Average Salary in Slovenia 2022*, *Salary Explorer*, <https://www.salaryexplorer.com/salary-survey.php?loc=198&loctype=1&job=504&jobtype=3>.
11. John Woods, *Hungarian police officers' starting salary is lower than 520 EUR/month!*, *Daily News Hungary*, 11 maj 2022, <https://dailynewshungary.com/hungarian-police-officers-starting-salary-is-lower-than-520-eur-month/>.
12. *Oznaka: Niske plate policijskih službenika*, *Raport*, <https://raport.ba/tag/niske-plate-policijskih-sluzbenika/>.
13. *Protest policijskih službenika u BiH: 'Prosječna plata nam je 665 KM'*, *Fokus*, 17 mars 2021, <https://www.fokus.ba/vijesti/bih/protest-policijskih-sluzbenika-u-bih-prosjecna-plata-nam-je-665-km/2021136/>.

Huliganizmi në futboll në Ballkanin Perëndimor nxjerr në pah lidhjet midis huliganizmit, politikës, dhunës dhe krimit, edhe pse këto ndryshojnë nga njëri vendi i rajonit në tjetrin.

“Sot është e diel”—dita e ndeshjeve të futbollit. Kështu gëzon një artist për klubin e tij të pëlqyer të futbollit, KF “Partizani”, me grafiti në Beograd, ku citon poetin e famshëm serb dhe tifozin e futbollit Dusko Radoviçin. Citimi ka të bëjë me ditën kur luhen zakonisht ndeshjet e futbollit. Vepra artistike murale bën thirrje për ndjenjën e respektit, këmbënguljes, besnikërisë dhe integritetit.

Por në Ballkanin Perëndimor, në të dielat e futbollit herë pas here shfaqen të kundërtat e këtyre vlerave. Tifozët thërrasin shprehje raciste dhe nacionaliste, ndërsa mbështetësit e ekipeve rivale rrihen me grushte me njëri-tjetrin ose me policinë. Ky nuk është problem që ndodh vetëm në Ballkan, por siç tregohet në një raport të ri të GI-TOC-së, në disa raste ka lidhje ose hallka destabilizuese midis huliganëve të futbollit, politikës dhe krimit të organizuar.¹

Në hulumtimin tonë kemi analizuar 122 grupe tifozësh të klubeve të futbollit në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi dhe Serbi dhe kemi identifikuar 78 grupe, anëtarët e të cilit mund të konsiderohen “ultra”, d.m.th. shoqata të mirorganizuar të tifozëve të apasionuar të futbollit. Nga këto 78 grupe tifozësh kokëfortë, 21 mund të konsiderohen huliganë që paraqesin rrezik serioz për sigurinë, jo vetëm për shkak të nivelit të dhunës, por edhe për shkak të lidhjeve që kanë me politikën dhe krimin e organizuar.

Dhuna

Grupet e huliganëve në Ballkanin Perëndimor njihen për përdorimin e dhunës, sidomos në Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Dhuna që ndërlihet me futbollin shpesh nxjerr në dritë nëntone të fuqishme nacionaliste, ku tifozët këndojnë himnin kombëtar, shfaqin simbole fashiste dhe lartësojnë heronjtë e luftës.²

Raportohet se disa huliganë janë bërë pjesë e grupeve paramilitare, çka të jep të kuptosh se ekziston një lidhje



Vepër e artist mural në Beograd me mesazhin 'Sot është e diel (dita e ndeshjeve të futbollit)' të poetit serb dhe tifozit të KF 'Partizani', Dusko Radoviç.

Foto: Bahrudin Bandic



Pikturë murale që i kushtohet Zelimir Vidovic KELIT, ish-lojtar i KF 'Sarajevës' dhe ekipit kombëtar jugosllav të futbollit. Ai humbi jetën në luftë gjatë viteve 1990.

Foto: Bahrudin Bandic

midis ushtrimit të dhunës dhe ekstremizmit politik. Për shembull, anëtarë të Forcës së Bashkuar të Serbisë (që mbështet KF “Radin” të Beogradit), Firma (që mbështet KF “Vojvodinën” në Novi Sad)³ dhe ultrat që veprojnë në Mostar të Bosnjës dhe Hercegovinës (që mbështet KF “Zrinjskin”), kanë luftuar në konfliktet në Ukrainë dhe Siri.⁴ Veprimet e tyre shfaqen haptas shpesh dhe lavdërohen në platformat e rrjeteve sociale.




Figura 1 Grupe huliganësh të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor, që kanë lidhje me politikën dhe krimin.

Burimi: Saša Đorđević dhe Ruggero Scaturro, *Dangerous games: Football hooliganism, politics and organized crime in the Western Balkans*

Lojëra të rrezikshme: Huliganizmi në futboll, politika dhe krimi i organizuar në Ballkanin Perëndimor, GI-TOC, qershor 2022,

<https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2022/06/>

Football-hooliganism-politics-and-organized-crime-in-the-Western-Balkans-GITOC-SEEObs.pdf.

Dhunën nuk e ndaloj as karantinimi. Pandemia “kovid-19” la bosh stadiumet e futbollit, por nuk i vuri fre dhunës së dirigjuar nga huliganët. Në prill të vitit 2021, antagonizmi midis huliganëve të Mostarit, i krijuar për shkak të identitetit etnik, rezultoi në vandalizëm.⁵ Në po të njëjtin muaj, shqetësimet në lidhje me tensionet ndërmjet mbështetësve të “Red Starit” dhe “Partizanit” bënë që Departamenti Amerikan i Shtetit të jepte alarmin e kuq për dhunë të mundshme në Beograd.⁶

Politika

Në raportin e GI-TOC-së jepen shembuj të angazhimit të huliganëve të futbollit për qëllime politike në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Partitë politike i përdorin grupet e huliganëve për të çuar përpara agjendat e tyre, nëpërmjet thirrjeve dhe banderolave brenda stadiumeve dhe nxitjes së tensioneve etnike ose politike përpara zgjedhjeve. Gjithashtu, ata mund të veprojnë si biznes i tipit “merr me qera një turmë njerëzish”, që shërben si “muskul force” në demonstrata. Një tifoz në Banja Lukë të Bosnjës dhe Hercegovinës u shpreh: “Huliganët e futbollit veprojnë si ushtri private e politikanëve.”⁷

Në këmbim të mbështetjes nëpërmjet ushtrimit të dhunës, politikanët u japin drejtuesve të grupeve të huliganëve mundësi afariste joshëse dhe i sigurojnë se do të kenë mbrojtje politike në rast se hetohen ose ndiqen penalisht.

Krimi

Lidhja midis huliganëve dhe krimit është veçanërisht e fuqishme në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Maqedoninë e Veriut. Në Serbi, krimi i organizuar ka marrë përmasa shqetësuese.

Në Bosnjë dhe Hercegovinë, disa anëtarë “ultra” të grupeve si Lesinari, Horde Zlaja dhe Shkripari, kryejnë krime të vogla, por janë edhe pjesë e grupeve të krimit të organizuar, të cilat merren me trafikim drogash dhe kontrabandim armësh.¹¹ Në Maqedoninë e Veriut, grupet e huliganëve që veprojnë në Shkup, si Komiti dhe Shvercerat, njihen për shitës droge dhe kontrabandistë armësh, çka i ndihmon të financojnë veprimtari të tjera të paligjshme.¹²

Rreziqet në Serbi janë edhe më shqetësuese. Anëtarët e disa grupeve huliganësh merren me krim të organizuar të rëndë, por shijojnë një shkallë të kënaqshme mbrojtjeje nga politikanët. Anëtarët e “Janjiçarit”, mbështetës të KF “Partizanit”, kanë krijuar lidhje të ngushta me zyrtarët e shtetit (sidomos me oficerët e policisë) dhe me klanin e Kavaçit, grup i krimit të organizuar në Mal të Zi, i profilizuar në trafikimin e kokainës nga Amerika Latine drejt Evropës.¹³

Në shkurt të vitit 2021, policia serbe arrestoi drejtuesin e “Principit” (që mbështet KF “Partizanin”) pas kthimit të tij nga një mbledhje me klanin e Kavaçit në Mal të Zi.¹⁴ Policia arrestoi mbi 20 anëtarë të “Principit” dhe i akuzoi për veprat penale të shoqërimit për qëllime kriminale,




Figura 2 Niveli i rrezikut për shkak të fuqisë së lidhjeve midis huliganizmit, politikës, dhunës dhe krimit.

Burimi: Saša Đorđević dhe Ruggero Scaturro, *Dangerous games: Football hooliganism, politics and organized crime in the Western Balkans* Lojëra të rrezikshme: Huliganizmi në futboll, politika dhe krimi i organizuar në Ballkanin Perëndimor, GI-TOC, qershor 2022, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2022/06/Football-hooliganism-politics-and-organized-crime-in-the-Western-Balkans-GITOC-SEEObs.pdf>.

PËRDORIMI I MEDIEVE SOCIALE

Ultrat në Ballkanin Perëndimor përdorin mediet sociale për të shprehur ndjenjat, vlerat ose besimet dhe për të bashkëndarë dhe komentuar në lidhje me lëndën në fjalë; kryejnë biznese të ndërlidhura me grupin, p.sh. veprimtari promocionale me natyrë identitare; dhe rekrutojnë dhe mobilizojnë mbështetës për mitingje ose evenimente të caktuara.

Ultrat dhe grupet e huliganëve në Ballkanin Perëndimor zakonisht përdorin Facebook-un dhe Instagram-in.⁸ Ka edhe profile zyrtare, edhe profile jozyrtare. Nga llogaritë zyrtare zakonisht publikohen lajme, promovohet grupi i tifozëve dhe klubit, dhe shiten rroba e veshje të klubit të futbollit në internet. Ndryshe nga këto, shumë llogari

jozyrtare dhe llogari private shërbejnë si vegla për funksionimin e grupit ose komunikimin brenda tij.⁹

Grupet jozyrtare janë, në pjesën dërrmuese, jopublike, pra jo të hapura për publikun. Pjesë e tyre mund të bëhen vetëm individë të besuar. Këto grupe janë tërheqëse si për brezat e rinj, ashtu edhe për nostalgjikët e vjetër. Megjithatë, të rinjtë e kanë më të lehtë të bëhen pjesë e tyre. Ndonjëherë, mjafton të shpërndash postime dhe të kesh shokë të përbashkët me administratorët. Kur përdoruesit më të rritur në moshë duan të bëhen pjesë e grupeve, administratorët verifikojnë në fillim nëse kanë ndonjë lidhje me policinë.¹⁰

trafikimit të drogës, mbajtjes dhe trafikimit të armëve dhe vrasjes së rëndë.¹⁵

Siç shihet në figurën 2, niveli i rrezikut dhe lidhjet midis huliganizmit në futboll, politikës dhe krimit nuk janë

njëlloj në të gjitha vendet e rajonit. Problemi është më i theksuar në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Serbi, ndërsa lidhjet e huliganizmit me krimin nuk ekzistojnë në Shqipëri dhe janë të dobëta në Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe në Mal të Zi.

Ky artikull mbështetet në kërkimin e bërë në kuadër të studimit "Dangerous games: Football hooliganism, politics and organized crime in the Western Balkans. Lojëra të rrezikshme: Huliganizmi në futboll, politika dhe krimi i organizuar në Ballkanin Perëndimor, të përgatitur nga Sasha Gjorgjeviçi dhe Ruggero Scaturro dhe të botuar në qershor të vitit 2022. Mund ta gjeni në: <https://globalinitiative.net/analysis/hooligans-crime-balkans/>.



Shënime

1. Saša Đorđević dhe Ruggero Scaturro, *Dangerous games: Football hooliganism, politics and organized crime in the Western Balkans*, GI-TOC, qershor 2022, <https://globalinitiative.net/analysis/hooligans-crime-balkans/>.
2. Intervistë me një studiues mbi ekstremizmin e dhunshëm në Mostar, Bosnje dhe Hercegovinë, 7 maj 2021; Nemanja

Stevanović, *Ultradësničarski simboli na fudbalskim stadionima u Srbiji uprkos zakonskoj zabrani*, VOICE, 17 tetor 2021, [https://voice.org.rs/ultradėsnicarski-simboli-na-fudbalskim-stadionima-u-srbiji-uprkos-zakonskoj-zabrani/](https://voice.org.rs/ultradեսnicarski-simboli-na-fudbalskim-stadionima-u-srbiji-uprkos-zakonskoj-zabrani/); Marija Arnautović dhe Mirsad Behram, *Fašizam na svom terenu: Ekstremistički poklič i sa bh. stadiona*, Radio Slobodna Evropa, 13 nëntor 2020,

- <https://www.slobodnaevropa.org/a/fa%C5%A1izam-na-svom-terenu-ekstremisti%C4%8Dki-pokli%C4%8Di-sa-bh-stadiona/30946282.html>; *Srbija i nasilje u sportu: Zašto sovinizam pobeđuje sport u Srbiji – 'problem je uvek u vašoj kući'*, BBC na srpskom, 15 tetor 2021, <https://www.bbc.com/serbian/lat/srbija-58928316>; Fabio Bego, *Do Albanians like Fascism? An Iconographical Investigation on Social Media Material*, *Modern Diplomacy*, 3 janar 2020, <https://modern diplomacy.eu/2020/01/03/do-albanians-like-fascism-an-iconographical-investigation-on-social-media-material/>.
3. Intervistë me një gazetar në Beograd, Serbi, 5 gusht 2021.
 4. *Insajder bez ograncienja: 'Sukob oko sistema vrednosti'*, *Insajder*, 16 maj 2017, <https://insajder.net/sr/sajt/bezograncienja/4715/>.
 5. *U Mostaru desetoro privedeno zbog tuce huligana*, *Danas*, 25 prill 2021, <https://www.danas.rs/svet/u-mostaru-desetoro-privedeno-zbog-tuce-huligana/>; Mirsad Behram dhe Selma Boracic Mrso, *'Licilo je na 1993': Mostar uznemiren posljednjim huliganskim nasiljem*, *Radio Slobodna Evropa*, 26 prill 2021, <https://www.slobodnaevropa.org/a/incident-u-mostaru-huligani/31223736.html>.
 6. *Security Alert: Belgrade (Serbia), High risk of hooliganism when soccer clubs play on April 7*, *Overseas Security Advisory Council*, Bureau of Diplomatic Security, U.S. Department of State, 6 prill 2021, <https://www.osac.gov/Country/Serbia/Content/Detail/Report/01aa3735-31c3-480e-85b7-1b4849c094ab>.
 7. Intervistë me një anëtar Lesinari në Banja Luka, Bosnje dhe Hercegovinë, 6 maj 2021.
 8. Intervistë me një fans të 'Komiti' në Shkup, Maqedonia e Veriut, 5 prill 2021; Intervistë me një tifoz të City Park Boys në Shkup, Maqedonia e Veriut, 5 prill 2021.
 9. Po aty.
 10. Stevan Dojčinović et al, *Rat balkanskog podzemlja: Ubistva, veze u policiji i u vrhu drzave*, KRIK, 5 maj 2020, <https://www.krik.rs/rat-balkanskog-podzemlja-ubistva-veze-u-policiji-i-u-vrhu-drzave/>; Bojana Jovanović dhe Stevan Dojčinović, *Gangsters and hooligans: key players in the Balkan cocaine wars Gangsterët dhe huliganët: lojtarët kyç në luftërat ballkanike të kokainës*, OCCRP, 5 maj 2020, <https://www.occrp.org/en/balkan-cocaine-wars/gangsters-and-hooligans-key-players-in-the-balkan-cocaine-wars>.
 11. *Odredjen pritvor osumnjicenima V. Belivuk i drugi*, *Visi sud u Beogradu*, 6 shkurt 2021, <https://www.bg.vi.sud.rs/vest/2991/odredjen-pritvor-osumnjicenima-v-belivuk-i-drugi.php>.
 12. Po aty.
 13. Stevan Dojčinović et al, *Rat balkanskog podzemlja: Ubistva, veze u policiji i u vrhu drzave*, KRIK, 5 maj 2020, <https://www.krik.rs/rat-balkanskog-podzemlja-ubistva-veze-u-policiji-i-u-vrhu-drzave/>; Bojana Jovanović dhe Stevan Dojčinović, *Gangsters and hooligans: key players in the Balkan cocaine wars [Gangsterët dhe huliganët: lojtarët kyç në luftërat ballkanike të kokainës]*, OCCRP, 5 maj 2020, <https://www.occrp.org/en/balkan-cocaine-wars/gangsters-and-hooligans-key-players-in-the-balkan-cocaine-wars>.
 14. *Odredjen pritvor osumnjicenima V. Belivuk i drugi*, *Visi sud u Beogradu*, 6 shkurt 2021, <https://www.bg.vi.sud.rs/vest/2991/odredjen-pritvor-osumnjicenima-v-belivuk-i-drugi.php>.
 15. Po aty.

“Buletinet e Rreziqeve” janë publikime periodike nga observatorët tanë rajonalë, në bashkëpunim me rrjete të shoqërisë civile për të paraqitur të dhëna të reja dhe për të vendosur në kontekst tendencat e rrjeteve të krimit të organizuar, tregtisë së paligjshme dhe reagimit të shtetit ndaj tyre. Nëse dëshironi të abonoheni për të marrë numrat e ardhshëm të “Buletinit të rreziqeve”, ju lutemi regjistrohuni këtu ose dërgoni email në adresën almedina.dodic@globalinitiative.net.

MBI “INCIATIVËN GLOBALE”

Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar është një rrjet mbarëbotëror, i përbërë nga më shumë se 500 ekspertë të shpërndarë nëpër të gjithë globin. Iniciativa Globale ka krijuar një platformë për nxitjen e një debati më të gjerë dhe promovimin e përjasjeve inovative, për të krijuar një bazë të fortë për hartimin e një strategjie në nivel global kundër krimit të organizuar.

www.globalinitiative.net

Ky publikim u realizua me mbështetjen financiare të Fondit të Mbretërisë së Bashkuar për Konflikt, Stabilitet dhe Siguri. Përgjegjësia mbi përmbajtjen e këtij publikimi bie vetëm mbi GI-TOC, dhe përmbajtja nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Mbretërisë së Bashkuar.



**GLOBAL
INITIATIVE**
AGAINST TRANSNATIONAL
ORGANIZED CRIME